

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË

“3DR_CONSULTING” SHPK

Sot me datë 25.03.2022,

- **VALDETE BALLHYSA**, atësia Selman, shtetase shqiptar, lindur me 23/06/1974, në Çermë, Lushnje dhe banues në Tiranë, Kroit 03910074, Ndërtesa Nr.13, Hyrja Nr.3, Apartamenti Nr.4, Farkë, Selitë 1044, Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr.034991622 dhe NrPersonal H45623012Q.

Bazuar, në legjislacionin në fuqi veçanërisht, bazuar në nenet 68 e vijues të Ligjit Nr. 9901 dt.14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar me Ligjin Nr. 129/2014 , Ligjit Nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në dispozitat e Kodit Civil në cilësinë e ortakëve themelues si dhe në vullnetin tim të lirë të shprehur dhe në nenshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë shoqëria):

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 1


DATA E THEMELIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot në datë 25.03.2022, u themelua shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin

“3DR_CONSULTING” SHPK

2. Themeluesit e shoqërisë janë:

VALDETE BALLHYSA, atësia Selman, shtetase shqiptare, lindur me 23/06/1974, në Çermë, Lushnje dhe banues në Tiranë, Kroit 03910074, Ndërtesa Nr.13, Hyrja Nr.3, Apartamenti Nr.4, Farkë, Selitë 1044, Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr.034991622 dhe NrPersonal H45623012Q.



NENI 2

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekt i kësaj shoqërie do të jetë:

1.Studim, Projektim:

- a) Objekte civile-industriale-turistike mbi 5 kate;
- b)Objekte me skelet metalik;
- c)Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;
- d)Projektim furnizim me ujë -kolektorë shkarkimi;
- e)Projektim ujësjellës urbane –rurale;
- f)Projektim rrugë lokalë,rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore;
- g)Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m;
- h) projekte për mbrotjen kundra zjarrit.

2.Mbikqyrje dhe kolaudim për zbatimit të punimeve në ndërtim, ndërtime civile:


- a)punime gjurmimi në tokë;
- b)ndërtime civile dhe industrial;
- c)rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinat civile e industrial,veshje fasada;
- d)rrugë autostrada,ura, mbikalime, hekurudha,linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista portuale;
- d)ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje;
- e)punime për prishjen e ndërtimeve;
- f)impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre;
- g)punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri,plastik,metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- h)sinjalistika rrugore jo ndriçuese;
- i)barriera dhe mbrojtje rrugore.

3.Vlerësime mjedisore; Ndërmjetësim i aktiviteteve të projektimit, ndërtimit dhe supervizimit të objekteve me interes publik dhe privat.

4.Shoqëria ofron kryerjen e shërbimeve:

- a) Project Planning and Scheduling;
- b)ESP Planning;
- c)CPM Methods of Scheduling;
- d)EAV Methods of Scheduling;
- e)Cost Estimation and Pricing;
- f)Pert Risk Analyzing;
- g)Resource Allocation;
- h)EPS Resource Allocation për çdo projekt në fushën e ndërtimit me investitor të huaj apo vendas.

- Produkti time schedule and time cost - risk analysis in cost and time;
- Programi oracle primavera p6, msproject, Pert risk analysis;



- Per fazen negotiations and tendering dhe excecution;
- 6- sigma for cost analysis.

5.Ofrimin e kurseve dhe trajnimeve profesionale inxhinerike, projekte të punuara me dorë për lëndët arkitekturë teknike dhe vizatim teknik për lëndët e faktultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Arkitekturë etj, programët AutoCAD,Revit,QGIS,Etabs etj dhe si dhe në fusha të tjera të mundshme të formimit inxhinierik professional,Udhëheqese Diplomash.

6.Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me shpronësimet, çdo veprim apo operacion tjetër teknik, juridik e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

7.Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me legalizimet, çdo veprim apo operacion teknik, juridik e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

8.Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me Leje e ndërtimit në sistimin online e-albania, çdo veprim apo operacion teknik, juridik e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

9.Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me prokurimet të ndërmarra nga autoritetet kontraktore, furnizues apo sipërmarrës i shërbimit për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime:

a)Shërbime konsulence juridike

b)trajnim në LPP

c)përgatitje të dokumetacionit lidhur me dërgimin e ankesave ne KPP

d)module trajnimi lidhur me procedurën e prokurimit për punonjes të rinj në fushën e prokurimeve apo student të interesuar në procedurat e prokurimit,e)trajnime për ndjekjen e zbatimit brenda afateve lidhur me rekomandimet e lëna nga auditimi apo kontrollet nga ministritë përkatëse

f)trajtime shkresash për ndjekje të procedurave të ndryshme administrative dhe ligjore,g)trajnime mbi ndjekjen e zbatimit të kontratave pune shërbim/mall,shërbime konsulence për ndjekjen e hapave administrative nga përjashtimi i prokurimit publik

h)përgatitja e ankesave dhe kërkesave të personave fizik ose juridik

i) shërbime juridike në procedura të ndryshme të prokurimit, siç janë: përgatitja e dokumentave të tenderit, paraqitja e ofertave, ndjekja e procedurës së ankimit, etj

10.Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me ekzpertizën në gjykatë në lidhje me studim, projektim dhe mbikqyrje e zbatimit të punimeve në ndërtim, si dhe çdo veprim teknik, juridik e financiar të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

11.Cdo aktivitet tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor.

Për të gjitha aktivitetet që kërkojnë licenca të vecanta shoqëria do të angazhohet që tani për të plotësuar kërkesat e ligjeve të posacme.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 1.Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë deri në një afat të papërcaktuar.
- 2.Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Prokop Mima dhe Liman Kaba”, Rezidenca Olimpik, ZK.8270,Tiranë

KREU II

KAPITALI

NENI 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

1.Kapitali i regjistruar i shoqërisë do të jetë 300,000 (treqind mijw) lekë i përbërë nga 1 (një) kuotë.


2.Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është:
Kontributi në kapitalin e shoqërisë zotërohet nga Ortakët në masën :

- *VALDETE BALLHYSA, atësia Selman, shtetase shqiptar, lindur me 23/06/1974, në Çermë, Lushnje dhe banues në Tiranë, Kroit 03910074, Ndërtesa Nr.13, Hyrja Nr.3, Apartamenti Nr.4, Farkë, Selitë 1044, Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr.034991622 dhe Nr.Personal H45623012Q, zotëron 100% të kuotave.*

3.Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, apo të drejta).

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT



1.Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit të regjistruar për kontribute në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

2.Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

3.Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

4.Në të gjitha rastet zvogëlimi prek në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

1.Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen si më poshtë:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyrë tjetër përcaktuar në ligj.

2.Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme midis ortakëve.

3.Pjesët e kapitalit të regjistruar janë të transferueshme me rrugë trashgimie, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANET VENDIMARRËSE

1.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

2.Asambleja e përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet si më poshtë:

- a. Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;



- b. Ndryshimet e statutit;
- c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. Përcaktimi i shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c) dhe d);
- f. Mbikqytja e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. Miratimi i bilanceve;
- h. Zmadhim dhe zvogëlim kapitali;
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. Përfaqësimin në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
- l. Miraton rregulla procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. Cështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

3.Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

4.Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1.Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2.Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullisë.

NENI 10

KUORUMI

1.Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët, që zotërojnë me shumë se 30 % të kuotave.

2.Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për cështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave,

janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 te nenit 88 të këtij ligji.

3.Nëse kuorumi i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme, mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera.

3.Cdo ndryshim duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në regjistrin e shoqërisë.

NENI 12

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendimin për:


- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) Ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
- d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 13

ADMINISTRIMI

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.



Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë, duke patur të drejta të pakufizuara administrimi:

- **VALDETE BALLHYSA**, atësia Selman, shtetase shqiptar, lindur me 23/06/1974, në Çermë, Lushnje dhe banues në Tiranë, Kroit 03910074, Ndërtesa Nr.13, Hyrja Nr.3, Apartamenti Nr.4, Farkë, Selitë 1044, Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr.034991622 dhe NrPersonal H45623012Q.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme duke zbatuar politikat tregetare;
- b) Përfaqësojnë shoqërinë;
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë;
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Raportojnë para Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe të veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- h) Kryejnë detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e Përgjithshme mundet në cdo moment, të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë të votave. Statuti ose rregullore të tjera nuk mund ta kufizojnë ose heqin këtë të drejtë.

NENI 15

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

- 1.Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2.Administratorët të cilët kanë kryer veprime ose bërë marrëveshje të pa aprovuara nga asambleja, janë përgjegjës për dëmet e sjella shoqërisë dhe përgjigjen personalisht ose solidarisht për pasojat.
- 3.Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kalojë cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor, Përfundimisht , viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përmbushje të kësaj detyre eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

KREU 5

PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar e shoqërisë;
- b. Me vendimet e Asamblesë së Ortakëve;
- c. Me hapjen e procedurave të falimentit;
- d. Nëse nuk zhvillon aktivitet tregtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e. Me vendim gjykate.



NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

NENI 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

1.Ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën.

2.Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblenë e parë të përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave sipas dispozitave të neneve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 22

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me te tretët, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

VALDETE BALLHYSA

